



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 43-12/2018 regjistër (JR)
Datë 13.04.2023

Nr. 54 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2026, ditën e martë, në orën 08:40, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen që i përket:

KËRKUES: Gentian Trenova, përfaqësuar nga avokat E. B., me nr. licence {***}, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe/ose avokate G. P., anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. licence {***}.

OBJEKTI: Rishikimin e vendimit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova.

BAZA LIGJORE: Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkesit në kërkesën e paraqitur prej tij, i cili përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gentian Trenova (në vijim “kërkuesi”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 25, datë 20.06.2018, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë*. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).
2. Pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, vendosi *lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Trenova*.
3. Kërkuesi ka paraqitur në Kolegji kërkesë për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

3.1. Në gjykimin e çështjes së tij të rivlerësimit në Kolegji, pjesë e trupit gjykues, në cilësinë e anëtarit ka qenë edhe z. L. D., për të cilin, më datë 21.03.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të cilat kanë deklaruar fajtor të pandehurin L. D. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

3.2. Kërkuesi, pasi rendit konkluzionet mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e mësipërme e gjykatave mbi dënimin penal të z. L. D., pretendon se këto rrethana janë fakte të reja të dala pas vendimit të Kolegjit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, dhe plotësojnë kushtet ligjore që parashikohen nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile, për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit.

3.3. Kërkuesi pretendon se anëtari i trupit gjykues L. D. ka kryer vepër penale që ka ndikuar në dhënien e vendimit nr. 10, datë 19.11.2018, të Kolegjit. Pjesëmarrja e L. D., si anëtar i trupës gjykuese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, ka qenë në kundërshtim me kriteret ligjore të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke kryer njëkohësisht edhe një vepër penale të konfirmuar me vendim të formës së prerë. Sipas kërkuesit, kjo situatë e krijuar konsiderohet si shkelje e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me parimin e gjykimin nga një gjykatë e krijuar me ligj. Shkelja e këtij parimi, sipas tij, është konstatuar edhe në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, sipas së cilit kjo gjykatë ka vendosur në mënyrë unanime në lidhje me të drejtën e kërkuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”.

3.4. Kërkuesi, duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Kushtetuese¹, si dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sqaron se e drejta ndërkombëtare, që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”), ka një vend të posaçëm, duke i renditur ato pas Kushtetutës, si dhe duke i dhënë atyre fuqi mbiligjore në sistemin e burimeve normative.

3.5. Kërkuesi pretendon se kërkesa e tij për rishikimin e vendimit të formës së prerë nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit, plotëson kushtet e parashikuara nga nenin 494, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile.

3.6. Në përfundim të argumenteve që shoqërojnë kërkesën e paraqitur në Kolegj, z. Gentian Trenova kërkon rishikimin e vendimit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit dhe prishjen e vendimit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe rigjykimin e tij.

3.7. Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin të vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesi ka depozituar në Kolegj si në vijim:

- i. prokurën e posaçme nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.04.2023, nëpërmjet së cilës i përfaqësuari Gentian Trenova ka autorizuar avokat E. B. dhe avokate G. P., për përfaqësimin e tij në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit;
- ii. kërkesën, datë 13.04.2023, drejtuar Gjykatës së Lartë, për marrjen e kopjes së vendimit nr. 53801-00461-002021, datë 21.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- iii. vendimin nr. 10, datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; si dhe
- iv. më datë 19.10.2023, kërkuesi dorëzoi në Kolegj një kërkesë të titulluar “Plotësim aktesh”, e cila është protokolluar me nr. {***} prot., dhe ka bashkëlidhur vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3, të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe

¹ Vendimet nr. 6/2006; nr. 9/2010 dhe nr. 20/2011, të Gjykatës Kushtetuese.

Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

5. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi dhe, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
6. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi, sikurse në vendimin e mëparshëm të Kolegjit me nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson edhe në këtë rast, në mënyrë të përmbledhur, atë qëndrim për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve, për sa i përket juridiksionit rivlerësues e rishikues të Kolegjit, trupi gjykues vëren se në to parashikohet, në mënyrë të shprehur, vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga Komisioneri Publik.

6.1. Trupi gjykues ka theksuar se, nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashtruar prej kërkuarit, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së sipërcituar, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.

7. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimin e referuar më sipër, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues, si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti, sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenin 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Sikurse analizuar në detaj në vendimin e sipërcituar të Kolegjit, është analizuar përse procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pabazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkuari.
8. Nga leximi harmonik i dispozitës së nenit F, pika 8² e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile³, një vendim i GjEDNj-së që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin

² Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

³ “[...]. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj të mbrojtura në Kushtetutë.

9. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuarit. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm e zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivitetit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezultojnë edhe nga mënyra sesi është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8 të Nenit F të Aneksit të Kushtetutës.
10. Nga këto dy dispozita, të lexuara në harmoni me njëra-tjetrën, rezultojnë se vendimet e Kolegjit mund të ankimohen vetëm në GjEDNj dhe që pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë kur GjEDNj-ja ka gjetur shkelje të Konventës dhe protokolleve të saj. Në këtë kontekst, në kushtet që për kërkuarin nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja konkludon një shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të tij, duke rikonfirmuar pa përsëritur arsyetimin e kryer nga Kolegji në jurisprudencën e tij, kërkesa për rishikim nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas pikës 8 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile.
11. *Së fundmi* dhe si *obiter dictum*, trupi gjyqësor i Kolegjit sjell në vëmendje edhe se shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuarit Gentian Trenova janë të ngjashme me shkaqet e marra në shqyrtim më parë nga Kolegji dhe elaboruar në jurisprudencën e tij. Që vepra penale, për të cilën anëtar i trupit gjyqësor është gjetur fajtor, të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuar duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të atakuar nëpërmjet rishikimit ose që në momentin kur gjyqtari/gjyqtarja ka marrë vendimin, vullneti i tij/saj është vesuar për shkak të një veprë penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari/gjyqtareje në shkelje të parimeve të paanësisë e objektivitetit, provuar nga një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korigjuar një “dështim të drejtësisë”⁴.

⁴ *Shih Brumarescu kundër Rumanisë, Pravednaya kundër Rusisë, Bratyakin kundër Rusisë, ndër të tjerë.*

12. Fakti që, në rastin konkret, vepra e dënueshme penalisht është kryer nga z. L. D. para marrjes së detyrës si gjyqtar i Kolegjit, dhe disa vite para dhënies së vendimit të Kolegjit që kërkohet të rishikohet, e shkapton këtë lidhje logjike dhe ligjore që kanë dy rrethanat e mësipërme, duke mosplotësuar njëkohësisht *qenien gjyqtar dhe kryerjen e veprës të dënueshme penalisht*. Në vlerësimin e kushteve për rishikimin e një vendimi, rëndësi ka dhe fakti se, sipas dispozitës, vepra e dënueshme penalisht, jo vetëm duhet të jetë kryer gjatë periudhës që gjyqtari ka qenë në detyrë, por duhet të provohet dhe që ajo ka lidhje dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në vendimin mbi bazën e të cilit kërkohet rishikimi. Vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari, “Falsifikim i dokumenteve”, për nga lloji i saj, nuk rezulton të ketë lidhje dhe të duket se mund të ketë ndikuar për kërkuesin në vendimin në kuadër të procesit të rivlerësimit. Për sa kohë që kërkuesi nuk sjell asnjë argument dhe provë konkrete se kryerja e veprës penale ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me prekjen e interesave të tij, nuk shpjegohet se si kjo vepër penale mund të ketë ndikuar dhe të ketë qenë shkak determinant në vendimin e dhënë ndaj tij.
13. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në gjashtë germa e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se, jo pa qëllim kushtetutëbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përlligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
14. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesës së paraqitur prej kërkuesit, Gentian Trenova, për të cilin GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohet nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesi bën në nenin 494, germa “c”, të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës⁵ së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
15. Për sa më lart, kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Gentian Trenova nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, kjo kërkesë konsiderohet nga trupi gjykues si e papranueshme. Situatat e tjera të parashikuara nga legjisllacioni i brendshëm,

⁵ Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y.; vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit A. B.; vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit B. M..

për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.

16. Në kushtet që vepra penale, për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., referohet të jetë kryer vite përpara vendimit dhe nuk ka asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, neni 494 germa "c" e Kodit të Procedurës Civile nuk mund të argumentohet se gjen zbatim, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera⁶.
17. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit Gentian Trenova është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si e tillë, ajo nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuesit Gentian Trenova, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 10, datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit.

U shpall në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁶ Shih për referencë, vendimin që i përket kërkesës së znj. R. G. dhe vendimin që i përket kërkesës së znj. A. G..

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 54 datë 24.03.2026, për çështjen nr. 43-12/2018 regjistër (JR) datë 13.04.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Gentian Trenova, për rishikimin e vendimit nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislati në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.¹.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z.Gentian Trenova, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafin 16 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

¹ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-A.-Y._perفشire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares, jam dakord me vendimin nr. 54 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesës së kërkuetit Gentian Trenova, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 10, datë 19.11.2018 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”*, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, e bën të pabazuar kërkesën për rishikim të paraqitur nga kërkueti.
2. Në cilësinë e gjyqtares me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t’i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenin 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuetit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”*.
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”*.
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t’i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimeve të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores, jam kundër shumicës së trupit gjykues në vendimin nr. 54, datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Gentian Trenova, për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 10 (JR), datë 19.11.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe kam ndarë mendim ndryshe, për sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues¹ të Kolegjit, për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GjEDNj), sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494², shkronja “c”³ e Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente, ndër të tjera, në mendimin e pakicës ndaj kërkesës së kërkuarit R. T.⁴, si dhe mendimet paralele dhe qëndrimin e mbajtur prej meje, në kërkesat për rishikim të paraqitura në çështje të tjera⁵.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga Gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të

¹ Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupit gjykues në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.01.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues.

² Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] (c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; [...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.

³ Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019, të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

⁴ Vendimi nr. 19, datë 08.05.2025, i Kolegjit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit R. T., për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 26 (JR), datë 21.10.2019.

⁵ Vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 11 (JR), datë 03.07.2020; vendimi nr. 18, datë 08.05.2025, i Kolegjit, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 9 (JR), datë 26.06.2020, etj.

rëndësi e kujdes të posaçëm rregullimit në Kod të institutit të rishikimit të vendimit (si në rastin e shkronjës “c”), nuk mund të linte pa rregullim të specifikuar ndonjë përjashtim nga parashikimi i përgjithshëm i shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos e lënë të nënkuptohet nga zbatuesit e këtij Kodi as kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues dhe as ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore për ndikim në dhënien e vendimit nga trupi gjykues.

5.5. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së dhe lexuar në harmoni me përmbajtjen e nenit 494/c të Kodit të Procedurës Civile, ekziston një detyrim që vendimet e marra nga një trup gjykues, që nuk plotëson kërkesat e një gjykate “të krijuar me ligj”, duhet të rishikohen, për të siguruar që çdo padrejtësi e mundshme të korrigojohet. Ky pohim përbën një masë të nevojshme dhe merr një peshë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri, ku integriteti i procesit të *vetting*-ut, si një proces i jashtëzakonshëm e kalimtar, është thelbësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi, edhe integriteti i trupit gjykues është thelbësor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Çdo shkelje e këtij integriteti, si dënimi penal i një gjyqtari, duhet trajtuar me seriozitet për të ruajtur besueshmërinë e procesit gjyqësor.

5.6. Kolegji i Posaçëm i Apelit, si organi kushtetues më i lartë dhe e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, si institucioni i pavarur që Kushtetuta¹¹ i ka dhënë atributet e Gjykatës Kushtetuese¹² dhe i ka përcaktuar një mision të qartë, si dhe që vendimmarrjet e tij t’i bazojë në parimet e procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, sipas parashikimeve të Konventës, Kushtetutës, ligjit të posaçëm¹³ dhe ligjeve të aplikueshme, duhet të demonstrojë dhe të transmetojë siguri juridike dhe qartësi për ato aspekte të gjykimit që dhënia e drejtësisë i sjell për të zbatuar, sikurse është edhe mjeti i jashtëzakonshëm i rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

5.7. Dënimi penal i një anëtari të trupit gjykues, për arsye që nuk lidhen me vendimmarrjen e tij, por me kushtet për të qenë anëtar i këtij Kolegji, cenon standardin e integritetit gjyqësor dhe besueshmërinë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, pozitën vendimmarrëse të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, paanshmërinë e tij, si dhe standardin e gjykatës së krijuar me ligj, të parashikuar dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në fund të fundit, vendimi penal i formës së prerë ndaj një anëtari të trupit gjykues, që ka shqyrtuar ankimin e kërkuarit (në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit¹⁴, është një fakt i pakundërshtueshëm, i cili në një formë apo në një tjetër implikon sjelljen institucionale të

¹¹ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

¹² Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës parashikon: “[...] Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”.

¹³ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

¹⁴ Vendimi nr. 25, datë 20.06.2018, i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Gentian Trenova.

Kolegjit të Posaçëm të Apelit, integriteti institucional i të cilit duhet të mbrohet nëpërmjet zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, që e kanë sanksionuar atë.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi